

AKT THEMELIMI

i Shoqërisë “Albania Adventure 2” SHPK

Sot, në Tiranë, më 15 Maj 2024, ne Ortakët: Nadire Dedndreaj, atësia Mehmet, e datlindjes 04/06/1983 lindur dhe banues në Tiranë, me numër personal identifikimi I35604075K dhe Vladimir Dedndreaj, atësia Mark, i datlindjes 27/05/1979, lindur dhe banues në Tiranë, me numër personal identifikimi **H90527149T**, hartojmë Aktin e Themelimit të shoqërisë “Albania Adventure 2” SHPK, sipas kërkesave të legjislacionit shqiptar në fuqi, me dispozitat që vijojnë:

Neni 1

Themelimi

Shoqëria krijohet dhe ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe sidomos Ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Per Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”(i ndryshuar), aktet e tjera ligjore që do të jenë në fuqi gjatë veprimtarisë së Shoqërisë, si dhe me dispozitat e Statutit të Shoqërisë që i bashkangjitet ketij Akti Themelues.

- 1) Emri i shoqërisë është “**Albania Adventure 2**” SHPK (këtu më poshtë e quajtur “**Shoqëria**”). Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me pergjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 2) Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 3) Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Statutin e saj.

Neni 2

Selia

- 1) Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Tiranë, Bashkia Tirane, Njesia Administrative nr.11, Rruga Riza Cuka, Ndërtesë me Nr.Pasurie 9/21, Kod Unik 8310020151, Zona Kadastrale 8310, Kodi Postar 1025.
- 2) Shoqëria mund të themelojë degë në rrethe të ndryshme të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me ligjet e zbatueshme dhe Statutin.

Neni 3

Objekti

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

- 1) Organizimi i guidave turistike brenda dhe jashte vendit.

- 2) Organizimi i veprimtarive sportive malore të alpinizmit, si hiking, trekking dhe kacavjerrje shkembore, skive, snoeshoeing(rrathe debore).
- 3) Organizimi i sporteve dhe veprimtarive turistike ujore, perfshi kanotazh, kayaking dhe Stand Up Paddle, zhytjes nëujore me bombula dhe apnea.
- 4) Organizimi i veprimtarive te guides me automjete 4x4 jashte rruge.
- 5) Organizimi i veprimtarive te animacionit festiv. Guide me biçikleta ne rruge dhe terrene te tjera, Conyoning.

Neni 4 Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 5 Kapitali Themeltar dhe Ortaku i Vetëm

- 1) Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie, në vlerën 100.000 (njëqind mijë) Lekë, i përbërë nga 2(dy) pjesë(kuotë) vlera nominale e së cilave është prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.
- 2) Pjesmarrja e Ortakëve në kapitalin e shoqërisë është sipas kontributeve të mëposhtëme:
 - a. Ortaku **Nadire Dedndreaj, atësia Mehmet, e datlindjes 04/06/1983 lindur dhe banues në Tiranë**, zotëron 50% të kuotave të përbërë nga 1(një) kuotë e barabartë me 50.000(pesëdhjetëmijë) lekë.
 - b. Ortaku **Vladimir Dedndreaj, atësia Mark, i datlindjes 27/05/1979, lindur dhe banues në Tiranë**, zotëron 50% të kuotave të përbërë nga 1(një) kuotë e barabartë me 50.000(pesëdhjetëmijë) lekë.

Neni 6 Ortakët

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë.

Neni 7 Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar), organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

- 1) Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimmarrës;
- 2) Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë që i bashkëlidhet këtij akti.

Shoqëria do të administrohet nga Administratori, **Paola Tasho**, i bija e Thomait, e datlindjes 26/09/1991, lindur në Korçë dhe banues në Tiranë, me numër personal identifikimi J15926079W, për një afat për 5 vjet.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 8 **Audituesit ligjorë**

Audituesit ligjorë të Shoqërisë do të emërohen në përputhje me ligjin në fuqi dhe për çdo vit financiar vjetor për veprimtarinë e shoqërisë. Shoqëria do të emërojë Audituesin Ligjor.

NENI 9 **Pjesmarrja**

Ortaku themelues mund të vendos me vullnetin e tij, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 10 **Ngritja e degëve apo filialeve**

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 11 **Ruajtja e Sekretit**

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 12

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë, të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve të tyre me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Tiranë.

NENI 13


Dispozitat përfundimtare

Akt Themelimi u hartua në 3 (tre) kopje, me vlerë të njëjtë juridike për t'u administruar në baze të ligjit, një kopje për t'u dorëzuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe dy kopje mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

ORTAKËT E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“Albania Adventure 2 ” SHPK

Vladimir Dedndreaj



Nadire Dedndreaj

